



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE  
TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË  
EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.01.2022 DERI 30.06.2022,  
BASHKIA POLIÇAN”**

**Tiranë 2023**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”



### PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>4</b>
<b>I/1. Hyrje</b> .....	<b>4</b>
<b>I/2. Objekti i Auditimit</b> .....	<b>4</b>
<b>I/3. Qëllimi i Auditimit</b> .....	<b>5</b>
<b>I/4. Metodologjia e Auditimit</b> .....	<b>5</b>
<b>I/5. Konkluzioni</b> .....	<b>5</b>
<b>II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË POLIÇAN</b> .....	<b>6</b>
<b>III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:</b> .....	<b>24</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

### Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

#### I. PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit Tematik nr. 370 datë 18.04.2023 “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Poliçan” me shkresën nr. 874/13 prot., datë 23.05.2022 RPA mbi “auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dhe “Auditimin financiar” me shkresën nr. 1018/6 datë 20.01.2023, u konsiderua i nevojshëm zhvillimi në ambientet e Bashkisë Poliçan, i verifikimit dhe përpilimi i një akti nga audituesit e KLSH-së Znj. S.J. dhe Znj. E.K. në cilësinë e përgjegjës të Grupit të Auditimit, në prezencë të përfaqësueses së subjektit të auditimit Znj. F.H. me detyrë Drejtore e Financës e Bashkisë Poliçan dhe personi përgjegjës i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

#### I/1. Hyrje

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna: statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

#### *Nga verifikimi rezultoi që:*

Auditimi u krye në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 370 Prot, datë 18.04.2023, me objekt: “*Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022*” në Bashkinë Poliçan“.

Auditimi u krye nga:

1. E.K. përgjegjës grupi
2. S.J. anëtar

Auditimi filloi më 18.04.2023

Auditimi përfundoi më datë 26.05.2023.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacionit që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”; Vendimit nr. 63 datë 20.06.2020 “Rregullore e procedurave të Auditimit”; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 43, pika 1,3.

#### I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

#### I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësisë të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

#### I/5. Konkluzioni

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*a Për përmirësimin e Legjislacionit* në fuqi nuk është lënë masë;

*b Masa Organizative* janë lënë **15**, dhe janë pranuar **15** masa: **9** masa janë zbatuar plotësisht, **5** pjesërisht dhe **0** në proces, **1** masë është pa zbatuar;

*Nga zbatimi i rekomandimeve të lëna në RPA nga auditimi i mëparshëm, janë lënë 12 masa, dhe janë pranuar 12 të cilat nga verifikimi rezultuan: 4 masa janë zbatuar, 5 masa pjesërisht zbatuar, 2 masa në proces dhe 1 masë pa zbatuar;*

*Në total* janë **27** masa, pranuar **27** masa: **13** masa zbatuar, **10** masa pjesërisht, **2** masa në proces dhe **2** masa pa zbatuar;

*c. Për shpërblim dëmi* janë lënë 2 masa dhe pranuar 2 masa: rezultuan 2 masa në vlerën 714,450 lekë pjesërisht zbatuar (në proces);

ndërsa nga zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm janë lënë **4** masa në vlerën totale 20,683,328 lekë nga të cilat **3** masa në vlerën 7,856,342 lekë janë pranuar dhe **1** masë në vlerën 12,826,986 lekë është pa pranuar, **3** masa në vlerën totale 17,837,344 (7,856,342+ 12,826,986) lekë kanë rezultuar pa zbatuar dhe **1** masë pjesërisht zbatuar në vlerën 2,845,792 lekë.

Në total janë **6** masa në vlerën 21,397,778 lekë nga të cilat janë pranuar **5** masa në vlerën 8,570,792 lekë dhe **1** masë në vlerën 12,826,986 lekë pa pranuar, **3** masa pjesërisht zbatuar në vlerën 3,560,434 lekë dhe **2** masa pa zbatuar në vlerën 7,856,342 lekë;

*d. Masa për uljane borxhit tatimor* në bashkinë Poliçan janë lënë **2** masa në vlerën totale të mbetur 86,379 mijë lekë, është në proces 1 masë në vlerën 86,317 mijë lekë për të cilën është arkëtuar vlera 11,619 mijë lekë dhe mbetet vlera 74,698 mijë lekë, si dhe nuk është zbatuar një rekomandim në vlerën 62 mijë lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

### II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË POLIÇAN

Nga auditimi tematik i ushtruar në Bashkinë Poliçan nr. 370 Prot, datë 18.04.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Poliçan” dërguar me shkresën nr. 1018/6 prot., datë 20.01.2023, u konstatua se:

- Për auditimin e mëparshëm evaduar në periudhën 01.01.2022-30.06.2022, raporti përfundimtar i auditimit është dërguar në Bashkinë Poliçan me shkresën nr. 874/13 datë 23.05.2022, ka hartuar planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 1149 prot., datë 15.04.2022; - Për auditimin e fundit Raporti Përfundimtar i Auditimit është dërguar me shkresën nr.1018/6 prot., datë 20.01.2023 në Bashkinë Poliçan, ka hartuar dhe miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 89 datë 28.02.2023 me nr. 612 prot., datë 28.02.2023; Plani i veprimeve është dërguar në KLSH me shkresën nr. 637/1 prot., datë 20.03.2023.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ”Bashkia Poliçan ka kthyer përgjigje në KLSH për auditimin e mëparshëm me shkresën nr. 1149 datë 15.04.2022, brenda afatit 20 ditë nga marrja e shkresës; për auditimin e fundit: me Urdhër të Brendshëm të kryetarit të Bashkisë Poliçan me nr. 89 me nr.612 prot., datë 28.02.2023, për hartimin dhe miratimin e “planit të veprimit” dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të auditimit; Bashkia Poliçan ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr.637/1 prot., datë 20.03.2023 në tejkallim të afatit 20 ditë nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

- Bashkia Poliçan ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” dhe për masat e marra për zbatimin e tyre, me shkresë nr. 1754/53 prot., datë 10.12.2022 me objekt “Raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 874/13 prot., datë 23.05.2022 në Raportin Përfundimtar të Auditimit”; Ndërsa për “Gjetjet dhe rekomandimet e përcjella në RPA me nr. 1018/6 datë 20.01.2023”, nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak.

- Nga ana e saj Bashkia Poliçan iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë në datën 25.04.2023, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPASHkresërisht me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit” dërguar me shkresën nr. 874/13 datë 23.05.2022 nga ana e Bashkisë Poliçan është raportuar në KLSH mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 1754/54 datë 10.12.2022 në tejkallim të afatit 6 mujor (14 ditë me vonesë); për nivelin e zbatimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të përcjella në RPA me nr. 1018/6 prot., datë 20.01.2023, rezultoi se ky raportim nuk është bërë, pasi është brenda afatit 6 mujor i cili përmbushet në datën 24.07.2023.

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (në RPA nr. 874/13 datë 23.05.2022) u konstatua se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

- Është hartuar program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr.1754/52, datë 10.06.2022, ku është përcaktuar struktura ose punonjësi përgjegjës për zbatimin e rekomandimit si dhe janë shprehur mbi pranimin e plotë e të gjithë rekomandimeve. Nga Bashkia Poliçan është dërguar raporti mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1754/54, datë 10.12.2022, përtej afatit 6-mujor.

- Bashkia Poliçan nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 871/8 prot., datë 30.12.2021, pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, e konkretisht:

-Nga 27 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim, 27 Masa Organizative, janë realizuar 10 masa, janë në proces 11 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

-Nga 4 masa Për uljen e borxhit tatimor dhe detyrimet nga qiradhënia rezultojnë se janë pranuar plotësisht për zbatim, 2 masa janë realizuar pjesërisht, dhe 2 masa janë në proces realizimi.

- Nga 3 masa Shpërblim dëmi rezultojnë se janë pranuar këto masa, janë njoftuar të tre subjektet nga të cilat një prej subjekteve ka arkëtuar shumën e kërkuar prej 228,833 lekë dhe dy të tjerë janë ende në proces pasi nuk ka asnjë dokument për arkëtimin e tyre në shumën 714,450 lekë. Pra një masë është realizuar dhe 2 masa janë ende në proces.

-Nga 1 masë Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike është pranuar dhe janë marrë masat për punonjësit e prekur nga procedurat e prokurimit, pra është realizuar.

-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Poliçan: Ky rekomandim rezultojnë i pranuar dhe i realizuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 16-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:** Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin 2 rekomandime të zbatuara pjesërisht dhe 4 rekomandime të pa zbatuara. Gjithashtu rikërkohet përsheptimin e zbatimit për 11 rekomandime, të cilat janë në proces zbatimi.

#### **Menjëherë**

*Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Poliçan për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi nëpërmjet Urdhrave të Kryetarit janë ngarkuar gjithë menaxherët e njësive të strukturës organizative të bashkisë për ndjekjen e zbatimit të tyre. Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm përcjellë në RPA me shkresën nr. 874/13 datë 23.05.2022 janë verifikuar nga grupi i auditimit dhe vlerësuar me statusin “pjesërisht zbatuar”, “në proces zbatimi” dhe “pa zbatuar” janë rikërkuar në RPA me nr. 1018/6 datë 20.01.2023 dhe paraqiten si më poshtë:*

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Rekomandimi nr. 6.1:** Drejtoria Juridike të bashkëpunojë me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore për të identifikuar në kohë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e lëndëve djegëse me qëllim që ato të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke mos krijuar hapësira nga periudha, kur përfundon një autorizim deri në fillimin e autorizimit tjetër. *(Ky rekomandim është në proces dhe në vazhdimësi)*





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

*Nga verifikimi rezultoi se:* Bashkia po ndjek hapat e nevojshëm por jo të gjithë Subjektet janë pajisur me autorizim për hapësirat e krijuara nga përfundimi i njërit autorizim nga tjetri.

*Rekomandimi është në zbatuar pjesërisht*

**2. Rekomandimi nr. 8.1:** IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar. Në lidhje me këtë masë rezulton se nuk janë vendosur gjoba për shkak të mos plotësimit të stafit apo strukturës së IMTV. *(Ky rekomandim nuk është realizuar)*

*Nga verifikimi rezultoi se:* Struktura e IMTV Bashkia Poliçan është plotësuar pjesërisht, dhe si rrjedhojë do të përmirësohet edhe aktiviteti kësaj njësie.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**3. Rekomandimi nr. 13.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të kryer vlerësimin e sipërfaqeve të kaluara bashkisë referuar dokumenteve të ZVRPP-së dhe akteve të tjera ligjore dhe më pas të bëjë regjistrimin në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” për një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të vlerës së aktiveve që disponon Bashkia Poliçan. *(Ky rekomandim është në proces.)*

*Nga verifikimi rezultoi se:* Në bilancin e Bashkisë dhe në regjistrin e AAGJ të vitit 2022, është pasqyruar vlera e një toke bujqësore që përdoret për varrezat. Vlera prej 1,188,000 lekë është e kontabilizuar në llogarinë 210 “Toka, troje dhe terrene”.

*Rekomandimi është zbatuar*

**4. Rekomandimi nr. 14.1:** Titullari i Bashkisë Poliçan të marrë masa për të ngritur një komision për të kryer inventarizimin dhe vlerësimin e Pyjeve dhe Kullotave dhe më pas Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për regjistrimin e vlerës përkatëse në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione" për të patur një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të vlerës së aktiveve që zotëron Bashkia Poliçan. *(Ky rekomandim nuk është realizuar.)*

*Nga verifikimi rezultoi se:* Në regjistrin e AAGJ të Bashkisë Poliçan janë hedhur edhe pyjet, të cilat kanë kaluar me VKM nr. 896, datë 11.06.2008 në pronësi të Bashkisë Poliçan. Ato janë pasqyruar në regjistrin e AAGJ, në llog. kontabël 211 "Pyjet dhe kullotat" me vlerën zero (0). Përderisa nga bashkia nuk është ngritur një komision, për vlerësimin dhe kontabilizimin e tyre me vlerë.

*Rekomandimi është pa zbatuar*

**5. Rekomandimi nr. 15.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të pasqyruar saktë vlerën e aktiveve të llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksione” duke respektuar normat e amortizimit përkatëse. Të kryejë regjistrimin e vlerës së 9 apartamenteve që i kanë kaluar në pronësi nga Enti Kombëtar i Banesave. Të bëjë rregullimin e vlerës 7,999,217 lekë për projektin “Rivitalizimi i Tre Lagjeve në Qytetin Poliçan” në llogarinë përkatëse 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. *(Ky rekomandim është në proces.)*

*Nga verifikimi rezultoi se:* Në Bilancin e vitit 2022 Formati nr.7/a dhe Regjistrin e AAGJ për vitin 2022 në llog. 212 është bërë kontabilizimi në vlerë totale 8,124,835 lekë i apartamenteve në pronësi të bashkisë të transferuara nga EKB. Ky kontabilizim është bërë në llogarinë 212 “Ndërtime dhe konstruksione”. Gjithashtu është bërë sistemimi në kontabilitet i investimit “Rivitalizimi i tre lagjeve në qytetin Poliçan” në llogarinë 213 “Rrugë , rrjete dhe vepra ujore” në vlerë 7,999,217 lekë, duke e hequr nga llogaria 212 “Ndërtime





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

dhe konstruksione“. Ky investim paraqitet në Bilancin e vitit 2022 dhe regjistrin e AAGJ të vitit 2022 në llog. 213.

*Rekomandimi është zbatuar*

**6. Rekomandimi nr. 16.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për sistemimin e llogarive 214 "instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe 218 "Inventar Ekonomik" duke bërë klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël (kontabilizimin e vlerës së një kompjuteri 54,250 lekë) si dhe të bëjë vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve duke respektuar normat e amortizimit vjetor sipas zërave të aktiveve.

-Për këtë rekomandim nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se është sistemuar vlera e një kompjuteri 54,250 lekë, e cila ishte kontabilizuar gabim në llog 218 për vitin 2020. Sistemimi është bërë duke debituar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe duke kredituar llogarinë 218 "Inventar ekonomik". (*Ky rekomandim është në proces.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në bilancin e vitit 2022 Formati nr. 7/a dhe Regjistrin e AAGJ për vitin 2022 në llog. 214 është (sistemuar vlera e një kompjuteri 54,250 lekë, e cila ishte kontabilizuar në llog. 218 për vitin 2020. Sistemimi është bërë duke debituar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe duke kredituar llogarinë 218 "Inventar ekonomik".

*Rekomandimi është zbatuar*

**7. Rekomandimi nr. 18.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur zhbllokimin e garancisë për objektet e përfunduara për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve në vlerën 11,437,888 lekë.

-Për këtë rekomandim rezulton se gjatë vitit 2022 janë bërë zhblllokime të garancive të defekteve në vlerën 2,876,956 lekë, ndërsa për diferencën nuk është marrë asnjë angazhim për zhbllokimin e tyre në shumën 8,560,932 lekë. (*Ky rekomandim është në proces.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në Aktrakordimin e mjeteve në ruajtje për vitin ushtrimor 2022, është bërë zhblllokimi i garancive të defekteve në vlerën 2,876,956 lekë. Vlera e palikujduar të cilat e kanë përfunduar afatin e garancisë është 1,982,975 lekë. Vlera tjetër 26,070,924 lekë është e palikujduar, pasi nuk ka përfunduar afati i garancisë. Për vitin 2023 do të bëhet zhblllokimi i garancisë bankare të objekteve të përfunduara.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**8. Rekomandimi nr. 21.1:** Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Poliçan të mbikëqyrë procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve me qëllim që komisionet përkatëse të inventarizimit ta kryejnë atë në përputhje me të gjitha përcaktimet e duhura duke dokumentuar argumentet e vlerësimit të aktiveve lidhur me faktin nëse aktivi është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë. Dokumentacioni i hartuar në përfundim të procesit të vlerësimit të paraqitet për miratim të Kryetari i Bashkisë përpara se të procedohet me hapat e tjerë që pasojnë përfundimin e vlerësimit të aktiveve. (*Ky rekomandim është në proces.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim rezultoi në të njëjtin status.

*Rekomandimi është në proces*

**9. Rekomandimi nr. 22.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat që për Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (MPEE) të bëhet ndarja e tyre nga mbetjet e tjera bashkiake dhe më pas të bëhet shitja e tyre tek subjektet e pajisura me licencën e duhur. Në



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

rastin e materialeve të tjera të dokumentohet procesi i asgjësimit të tyre si dhe të ndiqen të gjitha procedurat për sasi të llojeve të ndryshme të materialeve që përfitohen nga kryerja e procesit të asgjësimit. *(Ky rekomandim është në proces.)*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Për vitin 2022, nuk ka patur nxjerrje jashtë përdorimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Drejtoria e Financës e ka marrë parasysh këtë rekomandim dhe për në vazhdimësi të punës së saj.

*Rekomandimi është zbatuar*

**10. Rekomandimi nr. 23.1:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Poliçan, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar. *(Ky rekomandim është realizuar pjesërisht.)*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim është në të njëjtin status.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**11. Rekomandim nr. 26.1:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan, të marrë masa për likuidimin e faturave për blerjet e kryera nga Autoriteti Kontraktor, duke mos tejkaluar afatin 30 ditor. *(Ky rekomandim është realizuar pjesërisht.)*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masat për të mundësuar likuidimin e faturave Brenda 30 ditëve, për të shmangur shtimin e detyrimeve të prapambetura.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**12. Rekomandimi nr. 4.1:** Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që ky i fundit të bëjë ngarkesën e tyre për detyrimet vendore që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Poliçan. *(Ky rekomandim është në proces dhe në vazhdimësi.)*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim rezulton në të njëjtin status.

*Rekomandimi është në proces zbatimi*

#### C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Rekomandim nr. 1.1:** Nga Bashkia Poliçan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 603,450 lekë pa TVSH nga OE “N. S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2238 Prot, datë 22.08.2018, me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare “R. K”, Bashkia Poliçan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

-Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Poliçan është njoftuar subjekti me shkresën nr. 2085, date 23.08.2022 për të cilën ende nuk ka asnjë likuidim dhe konfirmim nga subjekti. *(Ky rekomandim është në proces.)*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Veç njoftimeve nuk është bërë asnjë likuidim nga subjektet.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**2. Rekomandim nr. 2.1:** Nga Bashkia Poliçan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 111,000 lekë pa TVSH nga OE “N. S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 659 Prot, datë 04.03.2019, me objekt: “Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendrës së fshatit Mbrakull”, Bashkia Poliçan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

-Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Poliçan është njoftuar subjekti me shkresën nr. 2085, datë 23.08.2022 për të cilën ende nuk ka asnjë likuidim dhe konfirmim nga subjekti. (*Ky rekomandim është në proces.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nuk është bërë asnjë likuidim nga subjektet.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**3. Rekomandimi nr. 27.1.1:** Bashkia Poliçan të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur:

□ Arkëtimin e shumës 1,832,235 lekë për **4 masat**, përkatësisht: 44,465 lekë nga operatori ekonomik “I.” Shpk, 172,050 lekë nga operatori ekonomik “B”, 300,000 lekë nga z. A.Z. dhe znj. V.A. nga 150,000 lekë secili, 15,720 lekë nga z. S.L. 1,300,000 lekë nga gjobat e vendosura nga IMTV. (*Ky rekomandim nuk është realizuar.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim rezultoi në të njëjtin status.

*Rekomandimi është pa zbatuar*

**4. Rekomandimi nr. 27.1.2:** □ Arkëtimin e shumës për **4 masat** e pa zbatuara për shpërblim dëmi me vlerë totale 3,178,123 lekë (179,111 lekë, përkatësisht nga projektuesi i objektit “Kanali ujitës i fshatit Mbrakull”, 1,359,456 lekë përfituar nga operatori ekonomik “B” ShPK për blerje makineri, 12,931 lekë përfituar nga operatori ekonomik “N. H” për dorëzimin me vonesë të mallrave dhe 1,626,625 lekë shkaktuar nga subjekti “R” ShPK). (*Ky rekomandim nuk është realizuar.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim rezultoi në të njëjtin status.

*Rekomandimi është pa zbatuar*

**5. Rekomandimi nr. 27.1.3:** □ Arkëtimin e shumës për **4 masat** e pa pranuar për shpërblim dëmi me vlerë totale 12,826,986 lekë (480,147 lekë, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikimi i fasadave në shëtitoren Miqësia” dhe “Rehabilitimi i rrugës së tregut”, 1,636,012 lekë, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i zonës së pallateve të ish mapos dhe rikualifikimi i fasadave të pallateve”, 802,187 lekë lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për objekte ndërtimore” dhe 9,908,640 lekë, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe asfaltimi rrugës Prokuce-Bodure-Kapinovë”, Loti. Pra nuk rezulton asnjë arkëtim për shumat e kërkuara në vlerën totale prej 17,837,344 lekë. (*Ky rekomandim nuk është realizuar.*)

**Nga verifikimi rezultoi se:** Ky rekomandim rezultoi në të njëjtin status.

*Rekomandimi është pa pranuar*

**6. Rekomandim nr. 3.1:** Drejtoria Juridike në Bashkinë Poliçan të ndjekë me rigorozitet të gjitha hapat e procesit gjyqësor me qëllim arkëtimin e vlerës 2,845,984 lekë nga subjekti “R.” ShPK. -Ndaj subjektit “R.” shpk vijon procedura ligjore, pasi subjekti ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative Vlorë rivendosjen në afat të ankimit të Vendimit nr. 28 datë 16.01.2022 nr.30 Regjistri 1494/188 datë regj 30.09.2019 të gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë, ku seanca e radhës do të zhvillohet më datë 20.12.2022. (*Ky rekomandim është në proces.*)



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

*Nga verifikimi rezultoi se:* Për këtë rekomandim nuk është vendosur akoma nga Gjykata dhe vazhdon të jetë në proces.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

*“Mjedisi i kontrollit”*

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Për periudhën 2021 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS dhe punën e kryer prej tij.

*“Menaxhimi i Riskut”*

Bashkia Poliçan nuk ka hartuar një strategji risku. Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, si dhe mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë.

*“Aktivitetet e Kontrollit”*

- Titullari i Bashkisë Poliçan për vitin 2021 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.

*“Informimi dhe komunikimi”*

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit. Në lidhje me komunikimin e jashtëm, nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve.

*“Monitorimi”*

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Audit i Brendshëm nuk ka funksionuar e për rrjedhojë nuk ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenet 8/b,10,16, 21/pika2, me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike” dhe me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.2.2, shkronja (a) “Strategjia e Menaxhimi i Riskut”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 36-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Poliçan, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, për raportimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe hartimin e një plani menaxhimi për veprime korigjuese.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga verifikimi rezultoi se:* 1. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë deri tani nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

*Rekomandimi është pa zbatuar*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**2.2.Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për hartimin e një programi vjetor të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë titullarin e njësisë si dhe të vendosi rregulla e të evidentojë kërkesat dhe përgjigjet në lidhje me ndërveprimin e Bashkisë me qytetarët.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se: 2.** Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar dhe miratuar Planin vjetor të trajnimeve të stafit me shkresën nr. 542 prot., datë 21.02.2023; Ka krijuar një sistem komunikimi të brendshëm elektronik; nëpërmjet sistemit One Stop Shop realizon komunikimin me qytetarët.

*Rekomandimi është zbatuar*

**3. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2021 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1(auditues), pasi në strukturën e miratuar është përcaktuar vetëm 1 specialist i Sektorit të Auditit, kur në Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përbëhet nga jo më pak se tre punonjës. Mungesa e një strukture të plotë të NJAB ka sjellë mos hartimin dhe miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm. Mungojnë planet strategjike dhe plani vjetor 2021 nuk është miratuar nga titullari i bashkisë. Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 33%, ku është realizuar vetëm 1 auditim nga 3 të planifikuara. NJAB në hartimin e planit vjetor nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe vlerësimi i riskut për çdo angazhim si dhe nuk është marrë në konsideratë respektimi e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”. Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Mungon Memorandumi drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, neni 14, neni 16, me VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” neni 20, me MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020, Kapitulli II 2.4.1 Kapitulli III, pikat 3.1 “Plani strategjik”, 3.2 “Plani vjetor i auditimit” 3.5; 3.6 , 4.3 “Raportimi vjetor i veprimtarisë së NJAB tek titullari i subjektit publik dhe Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm” Kapitulli IV “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.1,4.1.2, 4.1.54.1.11 dhe 4.1.12. (Më hollësisht trajtuar në faqet 48-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** Titullari i Bashkisë të marrë masa që të plotësojë strukturën e Auditit të Brendshëm sipas kriterëve ligjore. Të hartohet dhe të miratohet karta e auditit. Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimeve si dhe të raportojë për realizimin e tyre. Në planifikim të marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, të realizojë të auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në Bashkinë Poliçan me shkresën nr.1018/6 prot datë 20.01.2023 përsa i përket rekomandimit të lënë për plotësimin e strukturës me Njësinë e Auditit të Brendshëm, do planifikohet për vitin e ardhshëm; ndërkohë Bashkia Poliçan në mungesë të Burimeve Njerëzore ka punësuar një audituese të jashtme.

#### *Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të PBA-së për periudhën 2021-2023, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Poliçan nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara për të hartuar PBA-të përkatësisht:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;
  - Këshilli Bashkiak nuk ka miratuar, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor të vitit përkatës;
  - Për hartimin e PBA-së nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan. Drejtorja e Financës dhe Buxhetit nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjesa publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit;
  - Nuk janë respektuar me rigorozitet afatet kohore në miratimin nga ana e Këshillit të dokumenteve të projekt buxhetit afatmesëm;
  - Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
  - Nga Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik.
- Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12, me Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore” dhe me Udhëzimin e MFE nr. 22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”.

**4.1.Rekomandim:** Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë të gjitha masat, që gjatë hartimit të Projekt Buxhetit Afatmesëm:

- Të përgatisë dhe të dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor brenda afateve ligjore;
- Gjatë procesit të hartimit të PBA-së të zhvillohen konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, si dhe të grumbullohen kërkesat buxhetore nga strukturat e bashkisë apo ato në varësi. Të gjitha këto hapa të dokumentohen në dosjen përkatëse të hartimit të PBA-së;
- Të respektohen afatet për të gjitha fazat në të cilat kalon procesi i hartimit të PBA-së;
- Dokumenti i PBA-së të publikohet për njohje nga komuniteti dhe palët e interesit;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

*Në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtorja e Financës dhe e Buxhetit /Bashkia Poliçan ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Janë zhvilluar konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit; është miratuar me VKB nr. 44 datë 24/12/2022 kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor brenda afateve të përcaktuara në ligj; Janë vlerësuar kërkesat



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

buxhetore të të gjitha njësive të strukturës organizative të bashkisë dhe njësive të varësisë; Janë hartuar raportet periodike të monitorimit të performancës së programeve, treguesit financiar dhe realizimi i produkteve dhe objektivave të programit.

*Rekomandimi është zbatuar*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ndryshimeve të bëra nga Bashkia Poliçan në buxhetin e vitit 2021 rezulton se:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, shtojca 4, pika c. (Më hollësisht trajtuar në faqet 53-64të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në hartimin e buxhetit vjetor:

- Të vlerësojë nevojat e të gjitha strukturave të bashkisë dhe ato në varësi;
- Të hartojë buxhetin në harmoni me objektivat dhe angazhimet e përcaktuara të bashkisë;
- Të dokumentojë në çdo rast arsyet e ndryshimit të buxhetit duke respektuar edhe afatet ligjore në ndryshimin e tij.

*Në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masat që rekomandimin ta zbatojë me hartimin e PBA 2024-2026 dhe Projekt Buxhetin Vjetor për vitin 2024.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Poliçan për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE, raportet e monitorimit brenda afateve ligjore. Kryetari i Bashkisë Poliçan në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Kryetari i Bashkisë Poliçan nuk ka miratuar rregullat specifike dhe proceduriale, që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë të plota, pasi nuk janë plotësuar në përputhje me shtojcën 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5, “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, si dhe nuk janë plotësuar të gjitha anekset (3,4,5). Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10,12,28,29,48. (Më hollësisht trajtuar në faqet 53-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të angazhohet në monitorimin efektiv të zbatimit të buxhetit si dhe të hartojë raportet periodike të monitorimit brenda afateve të caktuara. Raportet e monitorimit duhet të përfshijnë treguesit e monitorimit të performancës





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

së programeve, treguesit financiarë si dhe realizimin e produkteve dhe objektivave të programit.

*Në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit /Bashkia Poliçan ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit: me shkresën nr. 457 prot., date 10.02.2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Raporti i monitorimit të buxhetit dhe Raporti i Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2022.

*Rekomandimi është zbatuar*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohen pasaktësi në të dhënat e paraqitura në PBA mbi detyrimet e prapambetura. Nga kryqëzimi i të dhënave të PBA-së që mbulon periudhën 2021 me listën e detyrimeve të prapambetura konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar rezultojnë mospërputhje në shumën e stokut referuar Formatit C3. Më datë 31.12.2021 stoku real është 47,007,267 lekë më shumë se shuma e planifikuar për këtë vit në PBA 2021-2023. Për vitin 2021 vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në pasiv të bilancit prej 180,841,998 lekë në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk është e saktë, pasi një pjesë e detyrimeve janë të mbivendosura në llog.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Në MFE janë raportuar 78,602,845 lekë detyrime të palikujduara. Në raportim në MFE nuk është përfshirë vlera prej 84,239,116 lekë detyrim i prapambetur për investime të kryera nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për projektin “Ndërtim i rrjetit ujësjellës Poliçan Pronovik-Mbrakull”, të cilat në total janë 162,841,961 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.68/2017“Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, me Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 106, 107 dhe me Udhëzimin plotësues të MFE nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pika 113, 116, 117. (Më hollësisht trajtuar në faqet 53-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit gjatë hartimit të PBA-së të plotësojë saktë të dhënat lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, të kryejë verifikimin, regjistrimin dhe përputhjen e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Poliçan, sikurse paraqiten në bilanc dhe raportohen në MFE si dhe të hartojë planin e likuidimit të tyre.

*Në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit /Bashkia Poliçan ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit: me shkresën nr. 457 prot., date 10.02.2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Raporti i monitorimit të buxhetit dhe Raporti i Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2022.

*Rekomandimi është zbatuar*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me likuidimin e vendimeve gjyqësore nga Bashkia Poliçan konstatohet se në fund të vitit 2020 vlera detyrimeve është 11,145,776 lekë për 12 vendime gjyqësore, Ndërsa gjatë vitit 2021 është likujduar vlera prej 1,175,616 lekë dhe në fund të vitit 2021 ka mbetur pa u likujduar vlera prej 9,970,160 lekë. Gjithashtu, nga shqyrtimi i kohës së likuidimit të vendimeve gjyqësore vihet re se, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, si dhe nuk ka të miratuar nga Kryetari i Bashkisë një grafik, që duhet të ndjekë në likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

gjyqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe 8. (Më hollësisht trajtuar në faqet 53-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki, kur të kryejë likuidimet e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit është hartuar grafiku i shlyerjes së detyrimeve për vendimet gjyqësore dhe me shkresën nr. 2289 prot., datë 21.10.2021 i është dërguar Degës së Thesarit Skrapar. Janë shlyer detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në masën 27 % deri më 30.04.2023, duke respektuar edhe grafikun e shlyerjes së tyre.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga zyra e IMTV në Bashkinë Poliçan dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e IMTV-së, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 konstatohet se, IMTV-ja ka patur në strukturë 3 punonjës (1 kryeinspektor dhe 2 inspektorë). Në bazë të urdhrorit të Kryetarit të Bashkisë Poliçan për miratimin e strukturës nr. 09, datë 12.01.2021, struktura e IMTV-së ka funksionuar në mungesë të Kryeinspektorit (larguar) dhe vetëm me një inspektor deri më datë 01.06.2021, kur është emëruar dhe inspektori i dytë. Aktualisht IMTV ka vetëm 2 inspektorë, të cilët janë të diplomuar në Shkenca Kompjuterike dhe Ekonomik, në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore. Nga mosplotësimi sipas kriterëve ligjore i strukturës së IMTV për vitin 2021 nuk ka qenë funksionale. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Poliçan nëpërmjet strukturës së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masa për të bërë shpalljen e vendit vakant të Kryeinspektorit me qëllim fillimin e procedurave të rekrutimit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 13, me VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii, pika 1/c/i, pika 4.

**9.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Poliçan me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

*Menjëherë*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në strukturën e IMTV/Bashkia Poliçan me Vendimin nr. 70 me nr. 1065 prot., datë 13.04.2023, është emëruar si “Inspektor ndërtimi” 1 punonjës, duke lënë vetëm pozicionin e kryeinspektorit vacant, për mungesë të burimeve njerëzore.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 79,843,886 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezulton se gjendja e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore prej 71,614,856 lekë nuk rakordon me vlerën progresive prej 70,299,118 lekë të debitorëve të raportuar nga Drejtoria e Taksave dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

Tarifave Vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite në vlerën 6,062,715 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”Kreu II, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pikat 3.3 dhe 4.2. (Më hollësisht trajtuar në faqet 74-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Bashkia Poliçan në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël për vlerën e saktë të debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore, në bazë të rakordimit me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore. Për pasaktësitë e rezultuara nga auditimi i PF, të gjenden veprimet e gabuara dhe të kryhen sistemimet e nevojshme kontabël, duke i reflektuar në bilancin e vitit ushtrimor 2022.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në bilancin e vitit 2022 Format 1, 2 dhe 7/a si dhe në regjistrin e AAGJ janë bërë sistemimet e llogarive përkatëse sipas rekomandimeve të lëna.

*Rekomandimi është zbatuar*

**11. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2021 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 180,841,998 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 260,685,884 lekë. Për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve debitohet llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, të cilat duhet të rakordojnë. Pra gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërpasiv 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv, ku për vitin ushtrimor 2021 mosrakordimi është në vlerën prej 79,843,886 lekë. Kjo vlerë nuk është evidentuar as në gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. pika 42.

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Bashkia Poliçan në mbyllje të vitit 2022 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara (të prapambetura) në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” dhe shpenzimeve të konstatuara në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke i rakorduar ato. Për pasaktësitë e rezultuara nga auditimi i PF, të gjenden veprimet e gabuara dhe të kryhen sistemimet e nevojshme kontabël, duke i reflektuar në bilancin e vitit ushtrimor 2021.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në hartimin e bilancit të vitit 2022 llogaria 467 “kreditorë të ndryshëm” është mbyllur me vlerën e detyrimeve të prapambetura. Janë bërë sistemimet kontabël të llogarive. Për vitin 2022 llogaria e detyrimeve të prapambetura mbyllet me llogarinë 467 dhe si rrjedhim ato nuk paraqiten në bilancin e vitit 2022. Ky veprim është bërë në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e ministrisë së financave nr. 8, datë 09.3.2018 “për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15, Seksioni 3/1.

*Rekomandimi është zbatuar*



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,934,395 lekë. Nga analiza e kësaj gjendje rezulton se, vlera prej 1,229,500 lekë përfaqëson 4 projekte, të cilat i përkasin investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Poliçan, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", sipas aktiveve të kapitalizuar si pjesë e kostos totale të objektit. Ndërsa vlera prej 2,704,895 lekë vjen nga bashkimi i bilanceve me Komunën Vërtop në vitin 2015, për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike për objektet që i përkasin. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. pika 16/b.d dhe Aneksi 1 pika 2 Klasa 2.

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës prej 1,229,500 lekë të 4 studim projekteve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogarinë përkatëse 213 "Rrugë, rrjete vepra ujore" sipas zërave për të cilën janë realizuar, për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në Bilancin e vitit 2022 Formati nr. 7/a dhe regjistrin e AAGJ për vitin 2022 llog. 213 është sistemuar vlera 1,229,500 lekë. Vlera e projekteve nga llog. 202 është sistemuar në llog. 213.

*Rekomandimi është zbatuar*

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i analizave të llogarive të Aktiveve Afatgjata materiale në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2021 rezultuan veprime të gabuara kontabël, të cilat ndikojnë në pasqyrimin e pasaktë të gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë:

Në analizën e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 12,387,451 lekë e aktivitetit Projekti: “Rivitalizimi i Tre Lagjeve në qytetin Poliçan”, i cili sipas verifikimit të investimeve të kryera i përket llogarisë 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore".

Në analizën e gjendjes së llogarisë 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore" është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,459,884 lekë e aktivitetit “Varrezat e reja”, i cili sipas klasifikimit kontabël i përket llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

Në analizën e gjendjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 3,005,396 lekë që përfaqësojnë 50 artikuj të këtij grup aktivesh, të cilat sipas klasifikimit kontabël i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”.

Nga analiza e gjendjes së llogarisë 215 “Mjete Transporti” rezulton se vlera 288,000 lekë I përket 1 mjeti zjarrfikës, i cili është i dëmtuar, pra nuk është në gjendje pune dhe rrjedhimisht është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 "Mjete Transporti". Në fakt duhet kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara", për mjetin e zjarrfikësës të dëmtuar, jo në gjendje pune.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2/1 germa (e), Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik. (Më hollësisht trajtuar në faqet 74-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** 1.Në bilancin e vitit 2022 Formati nr. 7/a dhe regjistrin e AAGJ janë sistemuar vlerat e llogarive 212, 213, 214 sipas rekomandimit;

2. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit konfirmoi se në mbyllje të Bilancit të vitit 2022 vlera 288,000 lekë për mjetin “zjarrfikës”, u sistemua përsëri në llogarinë 215 "Mjete transporti ", pasi ky mjet është në gjendje pune. Për këtë mjet janë bërë shpenzime për mirëmbajtjen dhe furnizimin me karburant të tij. Gjithashtu është dërguar shkresë me nr. 1353 prot., datë 17.05.2023 në DRSHTRR Berat, me objekt “Kërkesë për regjistrim në Sistemin e mjeteve për 2 mjete zjarrfikës”.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 260,685,884 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Nga analiza e gjendjes së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” rezulton se:

- Në këtë gjendje janë përfshirë gabim në mënyrë të dubluar vlera e 8 faturave të pastrimit prej 10,431,890 lekë, vlera faturës së investimit “Rikonstruksion i Shkollës Refat Keli” prej 4,449,823 lekë, vlera e qirasë së objektit të marrë nga Bashkia Poliçan prej 2,220,000 lekë, pra në total 17,101,713 lekë, duke rritur artificialisht vlerën e detyrimeve në bilanc për këtë vlerë pasi ato janë evidentuar në llogarinë e 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

- Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë në mënyrë të gabuar dhe vlera prej 79,843,886 lekë, që i përket llogarisë së debitorëve, pra detyrimet që i kanë të tretët bashkisë (shtetit). Kjo vlerë duhej të përfshihej në gjendjen e llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime), e cila në bilanc (pasiv) është paraqitur me gjendje 0 lekë, kur ajo duhet të rakordonte me kundërpartinë e saj në aktiv llog.468 “Debitorë të ndryshëm” për këtë vlerë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. Pika 42, Aneksi 1, Pika 3.3.

**14.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve ndaj të tretëve llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në bilancin e vitit 2022 Formati nr.1 janë zbatuar rekomandimet si vijon: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm“ në aktivin e bilancit në vlerën 88,484,189 lekë përputhet me vlerën e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin, detyrime“ në pasiv të bilancit; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin, të drejta“ në aktivin e bilancit në vlerën 106,040,893





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

lekë përputhet me vlerën e llogarive 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to“, llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit“, llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa“, llog. 435 “sigurime shoqërore“, llog. 436 “Sigurime shëndetësore“ në pasiv të bilancit. Shuma e llogarive të mësipërme në pasiv të bilancit zënë vlerën 106,040,893 lekë.

*Rekomandimi është zbatuar*

**15. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 34,429,395 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 168,890,862 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3.

**15.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranura.

*Deri me datë 31.03.2023*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në bilancin e vitit 2022 Formati nr.1 janë zbatuar rekomandimet si vijon: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm“ në aktivin e bilancit në vlerën 88,484,189 lekë përputhet me vlerën e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin, detyrime“ në pasiv të bilancit; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin, të drejta“ në aktivin e bilancit në vlerën 106,040,893 lekë përputhet me vlerën e llogarive 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to“, llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit“, llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa“, llog. 435 “sigurime shoqërore“, llog. 436 “Sigurime shëndetësore“ në pasiv të bilancit. Shuma e llogarive të mësipërme në pasiv të bilancit zënë vlerën 106,040,893 lekë.

*Rekomandimi është zbatuar*

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se detyrimi që subjektet fizikë/juridikë dhe familjarë kanë ndaj Bashkisë Poliçan për vitin 2021 është 9,226,852 lekë, ndërsa gjendja e debitorëve në vlerë progresive në fund të vitit 2021 për 79 subjektet fizik/juridik është 23,722,328 lekë, për taksën e tokës bujqësore në vlerën 43,644,787 lekë dhe për taksat dhe tarifave familjare 2,932,003 lekë, në total borxhi është në vlerën 70,299,118 lekë, vlerë e cila është evidentuar në kontabilitet. Subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjatë vitit 2021 në 1 rast është kërkuar bllokimi i llogarive bankare për tatimpaguesin debitor dhe në 6 raste subjekteve debitorë për taksat dhe tarifave vendore është bërë njoftimi për vendosjen e masave administrative. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 60, datë 24.12.2020 “Për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2021”, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.

**1.1. Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave, që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej 70,299,118 lekë nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore për uljen e borxhit tatimor, janë marrë masa si njoftime, urdhër bllokim bankar, gjoha, janë ndjekur të gjitha këto procedura. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 dhe raportimit në MFE mbi debitorët dhe kreditorët, rezultoi se përgjatë vitit 2022 borxhi tatimor progresiv është ulur në vlerën 7.565.383 lekë, por deri në 31.12.2022 vlera e borxhit është 74,697,760 lekë.

*Rekomandimi është zbatuar pjesërisht*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2021, në Bashkinë Poliçan janë legalizuar gjithsej 12 objekte me vlerë totale detyrimi ndaj bashkisë për taksën e ndikimit në infrastrukturë 361,858 lekë, nga të cilët kanë paguar detyrimin 9 qytetarë dhe janë debitorë 3 qytetarë në vlerën 61,928 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Poliçan veprim në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 3 qytetarë me vlerë 61,928 lekë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Poliçan të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit/Bashkia Poliçan u bë me dije janë përsëritur njoftimet përkatëse (e vetmja masë), por rezulton se qytetarët janë larguar nga fshati Vodice ku kanë objektet; ASHK nuk ka detyrim ligjor për të moskryer shërbime për mospagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Rekomandimi është pa zbatuar*

Një përmbledhëse e debitorëve për periudhën 2011-2022 Bashkia Poliçan së bashku me NJA Vertop dhe NJA Terpan, jepet në tabelat më poshtë:

1. Për debitorët e “Taksës së Tokës bujqësore” (Bashkia bashkë me 2 NJA)





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

Nr	Emertimi	Nr.famil	Deri me 01.01.2022	Nr.famil	Detyrimi I vitit 2022	Arketuar deri me 31.12.2022	Perjashtuar	Nr.famil	Mbetur deri me 31.12.2022
1	B.Polican	189	767,013	323	301,069	286,770		191	781,312
2	Nj.A.Vertop	1,291	13,837,692	2,031	5,703,076	6,812,430	252,283	936	12,476,055
3	Nj.A.Terpan	1,277	29,040,082	1,565	5,221,387	2,150,742	10,812	1,297	32,099,915
	<b>Totali</b>	<b>2,757</b>	<b>43,644,787</b>	<b>3,919</b>	<b>11,225,532</b>	<b>9,249,942</b>	<b>263,095</b>	<b>2,424</b>	<b>45,357,282</b>

Burimi: Bashkia Poliçan

#### 2. Për debitorët e “Taksës familjare” (Bashkia)

Nr.	Emertimi	Deri me 01.01.2021	Detyrimi i vitit 2022	Arketuar deri me 31.12.2022	Perjashtuar	Mbetur deri me 31.12.2022
1	T. Familjare	2,932,003	1,544,744	1,955,204	64,229	2,457,314
	<b>Totali</b>	<b>2,932,003</b>	<b>1,544,744</b>	<b>1,955,204</b>	<b>64,229</b>	<b>2,457,314</b>

Burimi: Bashkia Poliçan

#### 3. Për debitorët e “Tarifës së Pastrimit” (NJA Vertop)

Nr	Emertimi	Nr. Famil	Detyrimi i vitit 2022	Arket deri me 31.12.2022	Nr.famil	Mbetur deri me 31.12.2022
1	T. Pastrimit	563	168,800	121,500	158	47,300
	<b>Totali</b>	<b>563</b>	<b>16,800</b>	<b>121,500</b>	<b>158</b>	<b>47,300</b>

Burimi: Bashkia Poliçan

#### 4. Për Subjektet debitore (Bashkia bashkë me 2 NJA)

Nr	Emertimi	Deri me 01.01.2022	Debitor gjatë vitit 2022	Paguar gjatë vitit 2022	Mbetur deri me 31.12.2022
1	B.Polican	19,197,889	2,791,778	248,340	21,741,327
2	Nj.A.Vertop	4,524,439	614,468	44,370	5,094,537
3	Nj.A.Terpan	-	-	-	
	<b>Totali</b>	<b>23,722,328</b>	<b>3,406,246</b>	<b>292,710</b>	<b>26,835,864</b>

Burimi: Bashkia Poliçan

#### 5. Për vlerën totale të detyrimeve deri më 31.12.2022:

Nr	Emertimi	Detyrimi deri me 31.12.2022
1	Taksa e tokës bujqësore	45,357,282
2	Taksa familjare	2,457,314
3	Tarifa e pastrimit	47,300
4	Subjektet debitorë	26,835,864
	<b>Totali</b>	<b>74,697,760</b>

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA, rezultoi se realizimi i zbatimit të rekomandimeve është i ulët në masën 34.2 %. Në gjykimin e grupit të KLSH –së ka ardhur si rezultat i mungesës së analizës së gjetjeve të konstatuara nga ana e Kryetarit të Bashkisë, GMS dhe strukturave të bashkisë Poliçan të ngarkuara me përgjegjësi; mungesës së bashkëpunimit mes strukturave dhe drejtorisë ligjore, për të hartuar plane masash efektive dhe përpiluar shkresa zyrtare me një formulim të plotë me aktet ligjore/nënligjore.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA, rezultoi se realizimi i zbatimit të rekomandimeve është i ulët në masën 37 %. Në gjykimin e grupit të KLSH –së ka ardhur si rezultat i mungesës së analizës së gjetjeve të konstatuara nga ana e Kryetarit të Bashkisë, GMS dhe strukturave të bashkisë Poliçan të ngarkuara me përgjegjësi; mungesës së bashkëpunimit mes strukturave dhe drejtorisë ligjore, për të hartuar plane masash efektive dhe përpiluar shkresa zyrtare me një formulim të plotë me aktet ligjore/nënligjore.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

### III.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Poliçan për Projekt Raportin e Auditimit dërguar meshkresënr. nr. 1018/6 prot., datë 20.01.2023, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Poliçan me nr. 371 prot., datë 02.02.2023, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për të dy raportet e dërguara për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka njoftuar brenda 6 muajve për raportin e parë të auditimit ndërsa për raportin e dytë nuk është përmbushur afati i cili është në datë 24.07.2023 mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka raportuar për raportin e parë të auditimit **por nuk ka raportuar** për raportin e dytë të auditimit në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Poliçan për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 874/13 prot., datë 23.05.2022 dhe nr. 1018/6 prot., datë 20.01.2023, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjorederi në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

### B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Rekomandimi nr. 6.1:** Drejtoria Juridike të bashkëpunojë me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore për të identifikuar në kohë subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e lëndëve djegëse me qëllim që ato të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke mos krijuar hapësira nga periudha, kur përfundon një autorizim deri në fillimin e autorizimit tjetër.

*Menjëherë*

**2. Rekomandimi nr. 8.1:** IMTV të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe të sigurohet që në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar. Në lidhje me këtë masë rezulton se nuk janë vendosur gjoba për shkak të mos plotësimit të stafit apo strukturës së IMTV.

*Në vijimësi*

**3. Rekomandimi nr. 14.1:** Titullari i Bashkisë Poliçan të marrë masa për të ngritur një komision për të kryer inventarizimin dhe vlerësimin e Pyjeve dhe Kullotave dhe më pas Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për regjistrimin e vlerës përkatëse në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione" për të patur një pasqyrim të saktë dhe të drejtë të vlerës së aktiveve që zotëron Bashkia Poliçan.

*Menjëherë*

<sup>1</sup> Në kuadrat janë rekomandimet e lëna në RPA me shkresë nr.874/13 datë 23.05.2022 dhe rikëruar nga grupi auditues paraardhës në RPA me shkresë nr.1018/6 datë 20.01.2023 për kategorinë “Masa organizative” dhe më poshtë “Shpërbllim dëmi”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**4. Rekomandimi nr. 18.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur zhbllokimin e garancisë për objektet e përfunduara për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve në vlerën 11,437,888 lekë.

-Për këtë rekomandim rezulton se gjatë vitit 2022 janë bërë zhbllokime të garancive të defekteve në vlerën 2,876,956 lekë, ndërsa për diferencën nuk është marrë asnjë angazhim për zhbllokimin e tyre në shumën 8,560,932 lekë.

*Menjëherë*

**5. Rekomandimi nr. 23.1:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Poliçan, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

*Menjëherë*

**6. Rekomandim nr. 26.1:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Poliçan, të marrë masa për likuidimin e faturave për blerjet e kryera nga Autoriteti Kontraktor, duke mos tejkaluar afatin 30 ditor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Rekomandim nr. 2.1:** Kryetari i Bashkisë Poliçan, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, për raportimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe hartimin e një plani menaxhimi për veprime korrigjuese.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Rekomandim nr. 3.1:** Titullari i Bashkisë të marrë masa që të plotësojë strukturën e Auditit të Brendshëm sipas kritereve ligjore. Të hartohet dhe të miratohet karta e auditit. Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimeve si dhe të raportojë për realizimin e tyre. Në planifikim të marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, të realizojë të auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Rekomandimi nr. 5.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në hartimin e buxhetit vjetor:

- Të vlerësojë nevojat e të gjitha strukturave të bashkisë dhe ato në varësi;
- Të hartojë buxhetin në harmoni me objektivat dhe angazhimet e përcaktuara të bashkisë;
- Të dokumentojë në çdo rast arsyet e ndryshimit të buxhetit duke respektuar edhe afatet ligjore në ndryshimin e tij.

*Në vijimësi*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

**10. Rekomandim nr. 8.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki, kur të kryejë likuidimet e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Rekomandim nr. 9.1:** Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Poliçan (3 punonjës), me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

*Menjëherë*

**12. Rekomandim nr. 13.1:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

*Menjëherë*

#### C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Rekomandim 1.1:** Nga Bashkia Poliçan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 603,450 lekë pa TVSH nga OE “N. S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2238 Prot, datë 22.08.2018, me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare “R. K”, Bashkia Poliçan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**2. Rekomandim nr. 2.1:** Nga Bashkia Poliçan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 111,000 lekë pa TVSH nga OE “N. S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 659 Prot, datë 04.03.2019, me objekt: “Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendrës së fshatit Mbrakull”, Bashkia Poliçan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**3. Rekomandimi nr. 27.1.1:** Bashkia Poliçan të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për të bërë të mundur:

Arkëtimin e shumës 1,832,235 lekë për 4 masat, nga 4 operatorë përkatësisht: 44,465 lekë nga operatori ekonomik “I.” Shpk, 172,050 lekë nga operatori ekonomik “B”, 300,000 lekë nga z. A.Z. dhe znj. V.A. nga 150,000 lekë secili, 15,720 lekë nga z. S.L., 1,300,000 lekë nga gjobat e vendosura nga IMTV.

*Menjëherë*

**4. Rekomandimi nr. 27.1.2:** Arkëtimin e shumës për 4 masat e pa zbatuara për shpërblim dëmi me vlerë totale 3,178,123 lekë (179,111 lekë, përkatësisht nga projektuesi i objektit “Kanali ujitës i fshatit Mbrakull”, 1,359,456 lekë përfituar nga operatori ekonomik “B” Shpk për blerje makineri, 12,931 lekë përfituar nga operatori ekonomik “N.H” për dorëzimin me vonesë të mallrave dhe 1,626,625 lekë shkaktuar nga subjekti “R” Shpk).

*Menjëherë*

**5. Rekomandimi nr. 3.1:** Drejtoria Juridike në Bashkinë Poliçan të ndjekë me rigorozitet të gjitha hapat e procesit gjyqësor me qëllim arkëtimin e vlerës 2,845,984 lekë nga subjekti “R.” shpk. - Ndaj subjektit “R.” shpk vijon procedura ligjore, pasi subjekti ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative Vlorë rivendosjen në afat të ankimit të Vendimit nr. 28 datë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

16.01.2022 nr.30 Regjistri 1494/188 datë regj 30.09.2019 të gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë, ku seanca e radhës do të zhvillohet më datë 20.12.2022.

*Në vijimësi*

## B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

**1. Rekomandim nr. 1.1:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave, që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit i cili ne 31.12.2022 është në vlerën totale 74,697,760 lekë nga subjektet dhe familjet debitore, si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Rekomandimi nr. 2.1:** Drejtoria e Planifikimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 3 qytetarë me vlerë 61,928 lekë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Poliçan të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Poliçan (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:*

Nr	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar subjekti		Shkalla e pranimit në %	Statusi i rekomandimeve të pranuar									
		Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera	Nr	Vlera		Zbatuar		Pjesërisht zbatuar/proces		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
									Nr	Vlera	Nr	Vlera	Arkëtuar	Mbetejtja	Nr	Vlera	Nr	Vlera
1	Masa organizative	26	0	26	0	0	0	100	13	-	10 / 3				2		0	
2	Masa shpërbllim dëmi	6	21,397,778	5	8,570,792	1	12,826,986	83.3	0		3	3,560,242			2	5,010,550	0	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	0		0		0			0		0				0		0	
4	Mungesë të ardhurat	2	86,317,116	2	86,317,116	0		100	0		1	74,697,760	11,619,356		1	61,928	0	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
5	Masa disiplinore	0	0	0	0	0	0		0		0				0		0	
	- Me Status Nënpunësi Civil/punonjes	7																
	- Me kontratë pune/punonjes	1																
6	Masa Administrative	0	0			0					0						0	
	- Nga APP																	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
	-Nga IMTV																	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
11	Tjera	0	0						0	0							0	
	<b>TOTALI</b>	<b>34</b>	<b>107,714,894</b>	<b>33</b>	<b>94,887,908</b>	<b>1</b>	<b>12,826,986</b>	<b>91.7</b>	<b>13</b>		<b>14 / 1</b>	<b>78,258,002</b>	<b>11,619,356</b>		<b>6</b>	<b>5,072,478</b>	<b>0</b>	



## KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Poliçan”

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike								
			Pranuar në numër	Zbatu në numër	Zbatu pjesëri sht/proces numër	Pa zbatu në numër	Rekomanduar		Pranuar		Per Zbatuar/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal ne 00/lek	Pazbatuar (Pa fill proced)	
							Nr. Pers/ taks	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/ lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
a	b														
I.	Në fushën e legjislacionit	0					0							0	
1	Shfuqizim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Përmirësim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
II.	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsej, Ne vlere)	26	26	13	10 / 1	2	0	0						0	
III.	MASA SHPERBLIM DEMI/	6	5	0	3	2	15	21,397,778	11	8,570,792	3	3,560,242	0	12	5,010,550
IV.	TE ARDHURA TA MUNGUARA	2	2	0	1	1	2	86,317,116	2	86,317,116	1	74,697,760	0	1	61,928
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar, ne Financë)														
V.	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	0					0							0	
VI.	MASA DISIPLINORE	0					0							0	
	(Nga te cilat nuk janë nxjereurdhurat,vendimi)														
VII.	MASA ADMINISTRATIVE	0					0	0						0	
	Nga të cilat:	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjobat Inspektoriateve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)														
	Gjobat e APP	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)														
	<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>33</b>	<b>13</b>	<b>14 / 1</b>	<b>5</b>	<b>17</b>	<b>107,714,894</b>	<b>13</b>	<b>94,887,908</b>	<b>4</b>	<b>78,258,002</b>	<b>0</b>	<b>13</b>	<b>5,072,478</b>